



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SPITALIT PSIKIATRIK

Nr. _____ prot.

Vlorë, më _____.____.2025

Lënda: PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - MALL

ARGUMENTIM DHE MIRATIM I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

I mbajtur sot më datë 13.03.2025, në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, nga Njësia e Prokurimit, ngritur nga Autoriteti Kontraktor, në lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme :

Objekti Prokurimit: “Materiale Mjekimi”

Loti I – Materiale mjekimi (të përgjithshme)

Loti II - Materiale mjekimi (konsumi dhe kirurgjikale)

Referenca

REF-41071-03-13-2025

Loti I - REF-41074-03-13-2025

Loti II - REF-41078-03-13-2025

Vlera e fondit limit: 620,614..00 (gjashtëqind e njëzetë mijë e gjashtëqind e katërmëdhjetë) **lekë pa tvsh**

Loti I – 304,701.00 (treqind e katër mijë e shtatëqind e një) **lekë pa tvsh**

Loti II - 315,913.00 (treqind e pesë mbëdhjetë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë) **lekë pa tvsh.**

Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor (AK) për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë. Nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm. Gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në

respekt të nenit 77 pika 1 dhe pika 4 në Ligjin nr.162 dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Në bazë të kriterëve të veçanta të kualifikimit hedhur në sistemin e APP^{së} sipas Dokumentave Standarte të Tenderit (DST) AK hartoi DST^{ën}, mbështetur në ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, duke përcaktuar kërkesat e veçanta për kualifikim.
(përveç kriterëve të përgjithshme që janë të pa ndryshueshme në DST)

Për sa më sipër AK argumenton këto kritere, referuar VKM Nr.285/ 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V "Dokumentet e Tenderit":

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Argumentimi: Mbështetur në Ligjin nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 41/5 pika a: 5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Licencë e lëshuar nga QKL ose QKB për tregtim me shumicë të barnave

Argumentimi: Ky kriter mbështetet ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" neni 77 pika 1 ku për të vërtetuar se Operatori Ekonomik pjesëmarrës kryen veprimtari sipas objektit të procedurës së prokurimit, AK kërkon nga OE paraqitjen e një dokumenti ligjor i cili shërben për të vërtetuar veprimtarin që OE kryen si dhe është ose jo në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit.

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Vërtetim nga dega e tatim taksave ku të vërtetohet realizimi i xhiros mesatare vjetore, në një vlerë deri në 40% të fondit limit të lotit/ loteve për të cilat OE merr pjesë për 3 (tre) vitet e fundit financiar (2021, 2022, 2023).

Argumentimi: Operatori ekonomik nëpërmjet deklaratimit të xhiros vjetore, duhet të tregojë nëse ka kryer xhiro për vitet e kërkuara, në një vlerë deri në 40% të fondit limit të lotit/ loteve që do prokurohet. Kjo kërkesë mbështetet në ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" neni 77 si dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

neni 43 pika 1: kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2.3 Për kapacitetin teknik:

Referuar Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 77 pika 4 parshikon: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

2.3.1 Furnizime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë deri në 20% të fondit limit të lotit/ loteve për të cilat OE merr pjesë. Furnizime këto të realizuara gjatë tre viteve të fundit (**2021, 2022, 2023**) nga data e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Vendorsja e këtij kriteri tregon faktin që operatorët ekonomike kanë realizuar gjatë tre viteve të kërkuara kontrata të ngjashme të përmasave të tilla me objektin që prokurohet. Ky kriter mbështetet ligjin Nr.162, datë 23.12.2021 "Për Prokurimin Publik", neni 77 pika 4 si dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 55 pika 4/b.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese.

Argumentimi: Për të pasur një cilësi sa më të lartë dhe produkte origjinale të ardhur nga firma prodhuese dhe jo nga firma fantazëm, kërkojmë nga operatori pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të disponojnë deklaratë mbi origjinën, autorizimin nga firma prodhuese për operatorin shitës. Për këto kritere jemi bazuar në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 77 si dhe në nenin 79.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent, ose ISO 13485 "Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë", /ose ekuivalent/, të vlefshme, për prodhuesin/ të artikujve të ofruar. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Certifikatat ISO 9001-2015 përcaktojnë kriteret për një sistem të administrimit të kualitetit. Nepermjet implementimit të kësaj norme ndërkombëtare Operatori Ekonomik provon aftësinë e tij për të siguruar në mënyrë të vazhdueshme produkte të cilat janë në përputhje me kërkesat e klientit si dhe ato ligjore.

2.3.4 Ofertuesi duhet te paraqese Çertifikate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC, (të përditësuar) ose MDR, per te gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuar ose certifikate FDA

Argumentimi: Çertifikata e konformitetit është një dokument ku tregohen kriteret e përgjithshme që do të përdoren për projektimin dhe ndertimin e disa kategorive të pajisjeve mjekësore në fuqi në BE. Kjo imponon që në produktet që do të tregohen duhet të jete shënuar shenja (logo) CE.

Këto kritere mbështen në ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 79.

.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

PERSONI I AUTORIZUAR

Loreta BALAJ